

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti Juridik
Titulli i lëndës:	E Drejta Ndërkombëtare Publike
Niveli:	Bachelor
Statusi lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	III
Numri i orëve në javë:	3+2
Vlera në kredi – ECTS:	7
Koha / lokacioni:	15-00-17:00 / D2
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof. Enver Hasani
Detajet kontaktuese:	<a href="mailto:enver.hasani@uni-pr.edu">enver.hasani@uni-pr.edu</a> ; <a href="mailto:enver.hasani@gmail.com">enver.hasani@gmail.com</a>
<b>Përshkrimi i lëndës</b>	<p>Qëllimi parësor i kësaj lëndë është që t'i ofrojë studentëve njohuri bazike për këto çështje: kuptimi i së drejtës ndërkombëtare; natyra ligjore dhe burimet e së drejtës ndërkombëtare; aktorët kryesor dhe roli i tyre në formimin e së drejtës ndërkombëtare; territori dhe elementet tjera të së drejtës ndërkombëtare; njohja në të drejtën ndërkombëtare dhe rëndësia e saj; suksedimi i shteteve; organet përfaqësuese të shteteve, natyra dhe kuptimi i tyre; dhe në fund lënda mëton t'i ofrojë studentëve njohuri bazike mbi të drejtën e traktateve.</p> <p>Një vëmendje specifike do t'i kushtohet anës praktike dhe formale të së drejtës ndërkombëtare e shikuar si tërësi: si krijohet e drejta ndërkombëtare dhe shanset që ajo të bëhet një mjet efektiv në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërmjet shteteve dhe aktorëve tjerë të marrëdhënieve ndërkombëtare. Vëmendja fokusohet në efektivitetin e pjesëmarrjes së aktorëve ndërkombëtar në marrëdhëniet ndërkombëtare dhe rezultati dhe ndikimi i tyre në të drejtën ndërkombëtare. Kjo natyrisht nënkupton mësimet rreth aspekteve tjera të së drejtës ndërkombëtare, si ideologjia, ekonomia, diplomacia, forca ushtarake, dhe kështu me radhë. Këto aspekte diskutohen nga prizmi i së drejtës ndërkombëtare, dhe jo nga prizmi i shkencës politike ose lëmvive tjera. Fokusimi në aspektet ligjore të marrëdhënieve ndërkombëtare është korniza bazike mbi të cilën është zhvilluar kjo lëndë.</p>
<b>Qëllimet e lëndës:</b>	<p>Qëllim i kësaj lëndë është që t'i ofrojë studentëve njohuri bazike rreth çështjeve bazike të së drejtës ndërkombëtare, natyrën e saj dhe përmbajtjen në botën bashkohore.</p> <p>Rëndësia e kësaj lëndë theksohet derisa ajo tenton që të analizoj dhe aplikoj normat ndërkombëtare dhe parimet në kontekstin e zhvillimeve bashkohore në botë ashtu që studentët mund të formulojnë gjykimet e tyre në mënyrë të pavarur rreth natyrës dhe limitet e së drejtës ndërkombëtare. Aspekti krahasues do të mbetet gjithnjë pjesë e diskutimeve rreth normave, institucioneve dhe aktorëve të së drejtës ndërkombëtare.</p>
<b>Rezultatet e pritura të nxënies:</b>	<p>Pas përfundimit me sukses të kësaj lëndë, studentët janë në gjendje të:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Kuptojnë dhe shpjegojnë strukturë institucionale dhe normative të sistemit dhe shoqërisë ndërkombëtare, duke përfshirë këtu fillat e së drejtës ndërkombëtare;</li> <li>2. Kuptojnë dhe të dijnë të shfrytëzojnë burimet e së drejtës ndërkombëtare,</li> </ol>

	<p>si dhe mjetet tjera ndihmëse për identifikimin e së drejtës në rrafshin ndërkombëtar;</p> <p>3. Kuptojnë dhe shpjegojnë rolin e së drejtës ndërkombëtare në proceset ndërkombëtare vendimmarrëse;</p> <p>4. Njohin dhe kuptojnë aspektet specifike dhe të specializuara të së drejtës ndërkombëtare, si p.sh. përdorimi i forcës në të drejtën ndërkombëtare dhe limitet e saj, zgjidhja e mosmarrëveshjeve përmes mjeteve paqesore, suksedimi i shteteve dhe identiteti i shtetit në të drejtën ndërkombëtare;</p> <p>5. Fitojnë aftësi analitike dhe njohuri për prezentimin dhe argumentimin në mënyrë creative të rasteve dhe materialeve në të drejtën ndërkombëtare, duke përfshirë këtu në mënyrë specifike analizimi i teksteve ligjore dhe vendimeve gjyqësore.</p>
--	---

**Kontributi në ngarkesën e studentit ( gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)**

Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjërata	3	15	45
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Punë praktike	/	/	
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	15 min	15	3,75
Ushtrime në teren	/	/	
Kollokfiume, seminare	2	1	2
Detyra të shtëpisë	2	10	20
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	3	5	15
Përgaditja përfundimtare për provim	15	3	45
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	2	1	2
Projektet,prezentimet ,etj	4	5	20
<b>Totali</b>			<b>182.75</b>

**Metodologjia e mësimdhënies:**

Metodologjia e mësimdhënies në këtë lëndë përfshinë përdorimin e metodave të ndryshme interactive me qëllim që të bëhet analizimi i thuktë dhe bashkohor i parimeve kryesore dhe normave të së drejtës ndërkombëtare dhe aplikimi i tyre në praktikë. Kombinimi i metodave teorike dhe të studimit të rasteve praktike në interpretimin e këtyre normave dhe parimeve do të bëhet në mënyrë shumë të kujdesshme në mënyrë që studentët asnjëherë të mos e humbin fokusin në qëllimin e lëndës e cila mëton që të transmetoj tek ata njohuritë bazike rreth së drejtës ndërkombëtare, origjinën e saj, natyrën si dhe konceptet dhe institucionet bazike të saj.

Puna praktike do të fokusohet në rastet kryesore të GJND-së dhe tribunaleve tjera ndërkombëtare me qëllim të sqarimit të aspekteve specifike të së drejtës ndërkombëtare. Ana praktike, sidoqoftë, nuk do të thellohet në secilin detaj duke i lejuar studentët që dëshirojnë të specializojnë në këtë fushë që të orientohen në drejtimin modular në këtë fushë.

Përbri kësaj, çasja historike dhe krahasuese do të vihet në pah pasi që është në

	<p>dobi të studentëve që të kenë një shikim historik të zhvillimit normativ, parimeve dhe institucioneve të së drejtës ndërkombëtare deri më sot. Kjo është e vërtetë poashtu edhe sa i përket anës krahasuese të lëndës pasi që shumë institucione, norma dhe parime të së drejtës ndërkombëtare të cilat janë sot në fuqi kanë origjinën e tyre në sistemet e brendshme të shoqërive perëndimore.</p> <p>Rekomandohet që mësimdhënia të bëhet përmes pjesëmarrjes interaktive të studentëve. Studentët pritet që të marrin syllabusin në fillim të semestrit gjë që do t'i mundësoj atyre që të njoftohen me procedimin e lëndës ashtu që të jenë aktiv gjatë ligjeratave dhe diskutimit të temave të ndryshme.</p> <p>Për qëllim të ligjerimit do të përdoren mjete të ndryshme ndihmëse si projektori, tabela e bardhë etj.</p>
<p><b>Metodat e vlerësimit:</b></p>	<p>Do të ketë një provim final për vlerësimin e njohurisë së studentëve. Kjo do të përfshijë, nëse nuk është e specifikuar ndryshe, të gjithë literaturën obligative të caktuar. Provimi përfundimtar ngërthen 60 % të vlerësimit të përgjithshëm të performancës së studentit në këtë lëndë.</p> <p>Do të ketë një provim mes-semestral i cili do të përfshijë temat e lëndës të diskutuara deri në kohën e mbajtjes së provimit. Provimi mes-semestral ngërthen 30 % të vlerësimit të përgjithshëm të performancës së studentit në këtë lëndë.</p> <p>Pjesa tjetër prej 10 % do të vendoset sipas pjesëmarrjes aktive në klasë.</p> <p>E paraqitur në mënyrë më të ndryshme vlerësimi i studentëve do të bëhet si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Provimi mes-semestral: 30 %</li> <li>- Provimi përfundimtar: 60 %</li> <li>- Pjesëmarrja e rregullt dhe aktive në klasë: 10 %</li> </ul> <p><u>Rezultati final do të vendoset duke akumuluar rezultatet e arritura në dy provimet e organizuar gjatë rrjedhjes së semestrit (provimi mes-semestral dhe provimi përfundimtar) dhe rezultati i pjesëmarrjes aktive dhe të rregullt në klasë.</u></p> <p>Për më shumë, pjesëmarrja aktive dhe e rregullt mund të ngritë vlerësimin e studentit deri në 10% pikë shtesë. Kjo vendoset nga ana e profesorit.</p> <p>E një rëndësie të njëjtë është një mënyrë alternative të cilën studentët mund ta zgjedhin jashtë pjesëmarrjes aktive dhe të rregullt. Kjo nënkupton si më poshtë:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1) Studentët mund të zgjedhin një prezentim oral të një artikulli mbi një çështje që lidhet me të drejtën ndërkombëtare. Ky prezentim nuk mund të shkojë më gjatë se 15 minuta; ose</li> <li>2) Studentët mund të zgjedhin një prezentim të shkruar të një artikulli mbi një çështje të së drejtës ndërkombëtare;</li> <li>3) Artikujt e shkruar nuk mund të jenë më pak se 10 faqe dhe më shumë se 20, me numër rreshtor 1, fonti 12 Times New Roman</li> </ol> <p>Studenti konsiderohet të ketë kaluar me sukses lëndën pas arritjes së minimumit</p>

	<p>prej 55% të vlerësimit kumulativë gjatë aktiviteteve të tij të kërkuara.</p> <p>Në rastin e provimit mes-semestral dhe përfundimtar, rekomandohet që provimit të kërkojë nga studenti të shkruajë ese mbi tema të caktuara.</p> <p>Pjesëmarrja aktive në ligjerata dhe diskutimet në klasë mund të bartin deri në 10% të vlerësimit përfundimtar.</p>
<b>Literatura</b>	
<b>Literatura bazë:</b>	Zejnullah Gruda, <i>E Drejta Ndërkombëtare Publike</i> (Prishtinë: 2013)
<b>Literatura shtesë:</b>	<p>Antonio Cassese, <i>International Law</i> (Oxford University Press: Oxford, 2005)</p> <p>Lori F. Damrosch, Louis Henkin, Richard Crawford Pugh, Oscar Schachter, Hans Smit, <i>International law: Cases and Materials</i> (Ëest Group, Minnesota 2001).</p> <p>Enver Hasani, <i>Tema të Zgjedhura nga e Drejta dhe Marrëdhëniet Ndërkombëtare</i> (Prishtinë: Jalifat Publishing &amp; Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina, 2016)</p>
<b>Plani i dizajnuar i mësim:</b>	
<b>Java</b>	<b>Ligjerata që do të zhvillohet</b>
<b>Java e parë:</b>	<p><b>HYRJE</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Përmbajtja e lëndës, metoda, organizimi dhe kërkesat e lëndës</li> </ul>
<b>Java e dytë:</b>	<p><b>TEMAT KRYESORE TË SË DREJTËS NDËRKOMBËTARE</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Kuptimi dhe fillet e së drejtës ndërkombëtare</li> <li>• Fushat ku aplikohet e drejta ndërkombëtare</li> <li>• Marrëdhënia ndërmjet të drejtës ndërkombëtare dhe të brendshme</li> <li>• Zhvillimi historik i së drejtës ndërkombëtare</li> <li>• Zhvillimi i shkencës së të drejtës ndërkombëtare</li> <li>• Si ta kuptojmë të drejtën ndërkombëtare</li> </ul> <p style="text-align: right;">Literatura:</p> <p style="text-align: center;">Zejnullah Gruda, <i>E Drejta Ndërkombëtare Publike</i> (Prishtinë: 2013)  Enver Hasani, <i>Tema të Zgjedhura nga e Drejta dhe Marrëdhëniet Ndërkombëtare</i> (Prishtinë: Jalifat Publishing &amp; Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina, 2016)  Enver Hasani, <i>Tema të Zgjedhura nga e Drejta Kushtetuese</i> (Prishtinë: Jalifat Publishing &amp; Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina", 2016)</p>
<b>Java e tretë:</b>	<p><b>BURIMET, KODIFIKIMI DHE ZHVILLIMI PROGRESIV I SË DREJTËS NDËRKOMBËTARE</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Kuptimi i së drejtës ndërkombëtare</li> <li>• Traktatet dhe zakonet ndërkombëtare</li> <li>• Parimet e përgjithshme të pranuar nga popujt e civilizuar</li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Burimet ndihmëse të së drejtës ndërkombëtare: vendimet e gjykatave dhe doktrina juridike</li> <li>• Burimet tjera të së drejtës ndërkombëtare</li> <li>• Kodifikimi dhe zhvillimi progresiv i së drejtës ndërkombëtare globale dhe regionale</li> </ul> <p style="text-align: right;">Literatura: Zejnullah Gruda, <i>E Drejta Ndërkombëtare Publike</i> (Prishtinë: 2013).</p>
<b>Java e katërt</b>	<p><b>SHTETET SI SUBJEKTE KLASIKE TË SË DREJTËS NDËRKOMBËTARE</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Kuptimi i subjekteve të së drejtës ndërkombëtare</li> <li>• Krijimi dhe zhdukja e shteteve</li> <li>• Njohja e shteteve dhe e qeverive</li> <li>• Të drejtat dhe detyrimet e shteteve</li> <li>• Përgjegjësia e shteteve në të drejtën ndërkombëtare</li> <li>• Vijueshmëria dhe identiteti i shteteve</li> </ul> <p style="text-align: right;">Literature: Zejnullah Gruda, <i>E Drejta Ndërkombëtare Publike</i> (Prishtinë: 2013). Enver Hasani, <i>Tema të Zgjedhura nga e Drejta dhe Marrëdhëniet Ndërkombëtare</i> (Prishtinë: Jalifat Publishing &amp; Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina, 2016).</p>
<b>Java e pestë:</b>	<p><b>ORGANIZATAT NDËRKOMBËTARE DHE SUBJEKTET TJERA TË SË DREJTËS NDËRKOMBËTARE</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Kuptimi dhe llojet e organizatave ndërkombëtare</li> <li>• Individit si subjekt i së drejtës ndërkombëtare</li> <li>• Pakicat si subjekte të së drejtës ndërkombëtare</li> <li>• Subjektet tjera të së drejtës ndërkombëtare: lëvizjet çlirimtare, papa dhe Vatikani; rastet tjera specifike</li> </ul> <p style="text-align: right;">Literatura: Zejnullah Gruda, <i>E Drejta Ndërkombëtare Publike</i> (Prishtinë: 2013) Enver Hasani, <i>Tema të Zgjedhura nga e Drejta dhe Marrëdhëniet Ndërkombëtare</i> (Prishtinë: Jalifat Publishing &amp; Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina, 2016).</p>
<b>Java e gjashtë:</b>	<p><b>SUKSEDIMI NË TË DREJTËN NDËRKOMBËTARE</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Suksedimi në lidhje me traktatet</li> <li>• Suksedimi në lidhje me borxhet publike</li> <li>• Suksedimi në lidhje me pronën publike</li> <li>• Suksedimi në lidhje me arkivat dhe dokumentet tjera</li> <li>• Suksedimi në lidhje me shtetësinë</li> <li>• Suksedimi dhe të drejtat e fituara</li> </ul> <p style="text-align: right;">Literatura: Zejnullah Gruda, <i>E Drejta Ndërkombëtare Publike</i> (Prishtinë: 2013) Enver Hasani, <i>Tema të Zgjedhura nga e Drejta dhe Marrëdhëniet Ndërkombëtare</i> (Prishtinë: Jalifat Publishing &amp; Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina, 2016)</p>
<b>Java e shtatë</b>	

	<p><b>OBJEKTET E TË DREJTËS NDËRKOMBËTARE</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Kuptimi I territorit dhe kufirit shtetëror</li> <li>• Ujërat dhe sovraniteti</li> <li>• Hapësira ajrore/kosmike dhe sovraniteti</li> <li>• Servituted ndërkombëtare</li> <li>• Ndryshimet territoriale</li> </ul> <p style="text-align: right;">Literature:</p> <p>James R. Craëford, <i>The Creation of States in International laë</i> (Oxford University Press: Oxford, 2007) ;</p> <p style="text-align: center;">Zejnullah Gruda, <i>E Drejta Ndërkombëtare Publike</i> (Prishtinë: 2013).</p> <p>Enver Hasani, <i>Tema të Zgjedhura nga e Drejta dhe Marrëdhëniet Ndërkombëtare</i> (Prishtinë: Jalifat Publishing &amp; Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina, 2016)</p>
<p><b>Java e tetë:</b></p>	<p><b>Testi mes-semesteral (kollokuiumi)</b></p>
<p><b>Java e nëntë:</b></p>	<p><b>PREZENTIMI I TEMAVE NGA ÇËSHTJET AKTUALE TË SË DREJTËS NDËRKOMBËTARE DHE INTERPRETIMI I NORMAVE DHE PARIMEVE BAZIKE</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Intervenimi I paautorizuar me forcë në botën modern dhe “Ndërhyrja Humanitare”</li> <li>▪ Entitetet ilegale në të drejtën ndërkombëtare (“Republika Srpska” në Bosne dhe Herzegovinë, “Republika e Qipros Veriore” në Qipro, rasti I Biafras në Nigeria, Katanga në Kongo (Zaire) etj.)</li> <li>▪ Tema tjera relevante të së drejtën ndërkombëtare të cilat mund të ngriten gjatë semestrit</li> </ul> <p style="text-align: right;">Literatura:</p> <p>Literature shtesë do të caktohet varësisht nga zhvillimet aktuale të së drejtës ndërkombëtare në përgjithësi</p>
<p><b>Java e dhjetë:</b></p>	<p><b>ORGANET PËR PËRFAQËSIM NDËRKOMBËTAR</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Shefi i shtetit dhe qeverisë</li> <li>▪ Kuptimi dhe zhvillimi historik i shërbimit diplomatik</li> <li>▪ Periudha e përfaqësimit të përkohshëm</li> <li>▪ Diplomacia modern</li> <li>▪ Kodifikimi dhe zhvillimi progresiv i të drejtës diplomatike</li> <li>▪ Fillimi i misionit diplomatik</li> <li>▪ Llojet, klasat dhe rangu I përfaqësuesëve diplomatik</li> <li>▪ Gjuha diplomatike</li> <li>▪ Imunitetet dhe privilegjet diplomatike</li> <li>▪ Kuptimi i shërbimit diplomatic dhe zhvillimi historik</li> <li>▪ Llojet, klasa dhe rangu i konsujve</li> <li>▪ Fillimi i misionit konsullor</li> <li>▪ Funkcionet e konsullit</li> <li>▪ Marrëdhënia ndërmjet shërbimit diplomatik dhe konsullor</li> <li>▪ Imunitetet dhe privilegjet konsullore</li> <li>▪ Mbrojtja konsullore e personave pa shtetësi dhe refugjatëve</li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Ushtria si një organ i përfaqësimit ndërkombëtar</li> </ul> <p style="text-align: right;">Literature: Zejnullah Gruda, <i>E Drejta Ndërkombëtare Publike</i> (Prishtinë: 2013)</p>
<p><b>Java e njëmbëdhjetë:</b></p>	<p><b>E DREJTA NDËRKOMBËTARE NË VEPRIM</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Analizë dhe studim i rasti të mendimit këshillëdhënës të GJND-së mbi Kosovë dhe rasti i Gjenocidit (Bosna-Herzegovina vs. Serbia dhe Mali i Zi)</li> <li>• Analizë dhe studim e draft-marrëveshjes mbi demarkacionin ndërmjet Kosovës dhe Malit të Zi (Gusht 2015) dhe marrëveshjet tjera kufitare të Kosovës me fqinjët e saj</li> <li>• Analizë dhe studim mbi mundësinë sipas të drejtës ndërkombëtare që Serbia të paditet për dëmshpërblim për gjenocidin e bërë në Kosovë</li> </ul> <p style="text-align: right;">Literature: Xhezair Zaganjori, <i>Jurisprudencë dhe praktikë ndërkombëtare</i> (Shkolla e Magjistraturës: Tiranë, 2011) Enver Hasani, <i>Tema të Zgjedhura nga e Drejta dhe Marrëdhëniet Ndërkombëtare</i> (Prishtinë: Jalifat Publishing &amp; Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina, 2016)</p>
<p><b>Java e dymbëdhjetë:</b></p>	<p><b>VEPRIMET LIGJORE NDËRKOMBËTARE</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Aktet e njëanshme; notifikimi; njohja; protesta; kundërshtimi</li> <li>• Traktatet ndërkombëtare: kuptimi dhe llojet</li> <li>• Kodifikimi i të drejtës ndërkombëtare mbi traktatet</li> <li>• Palët në traktat</li> <li>• Organet e autorizuara për konkludimin e traktatit</li> <li>• Vullneti për të konkluduar traktatit: kërcënim dhe përdorimi i forcës; gabimi; mashtrimi; korrupsioni i përfaqësuesëve shtetëror dhe të tjerë</li> <li>• Objekti i traktatit</li> </ul> <p style="text-align: right;">Literature: Zejnullah Gruda, <i>E Drejta Ndërkombëtare Publike</i> (Prishtinë: 2013)</p>
<p><b>Java e trembëdhjetë:</b></p>	<p><b>ZGJIDHJA PAQESORE E MOSMARRËVESHJEVE NDËRKOMBËTARE</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Mjetet ekstra-juridike për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve: negociatat; shërbimet e mira dhe ndërmjetësimi; hetimi; pajtimi</li> <li>• Mjetet juridike për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve: arbitrazhi; Gjykata ndërkombëtare e drejtësisë</li> <li>• Zgjidhja e mosmarrëveshjeve në kuadër të organizatave ndërkombëtare: lidhja e kombeve; Kombet e Bashkuara, organizatat tjera.</li> </ul> <p style="text-align: right;">Literatura: Zejnullah Gruda, <i>E Drejta Ndërkombëtare Publike</i> (Prishtinë: 2013) Enver Hasani, <i>Tema të Zgjedhura nga e Drejta dhe Marrëdhëniet Ndërkombëtare</i> (Prishtinë:</p>

	Jalifat Publishing & Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina, 2016.
<b>Java e katërbëdhjetë:</b>	<p><b>E DREJTA NDËRKOMBËTARE E LUFTËS</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Definicioni i luftës</li> <li>• Luftat e drejta dhe të padrejta</li> <li>• Kundërshtimi i luftës: Lidhja e Kombeve; Pakti Birand Kellog; Kombet e Bashkuara</li> <li>• Burimet e të drejtës ndërkombëtare të luftës</li> <li>• Fillimi i konfliktit të armatosur dhe efektet e tij: Deklarata e luftës dhe ultimatumit; marrëdhëniet diplomatike, shtetasit e shteti armik, ndalimi i tregtisë dhe pasuria e shtetit armik</li> <li>• Palët në konfliktin e armatosur (pjesëmarrja e personit në konfliktin e armatosur)</li> <li>• Teatri i luftës</li> <li>• Mjetet, metodat dhe armët e ndaluara në konfliktin e armatosur</li> <li>• Personat e mbrojtur në konfliktin e armatosur: të plagosurit, të sëmurët dhe anijetherit; të burgosurit e luftës; civilët; personeli mjekësor; grupet religjioze dhe vullnetarët tjerë për qëllime humanitare</li> <li>• Obligimet ndaj të vdekurit</li> <li>• Objeket e mbrojtura gjatë konfliktit të armatosur: objektet mjekësore, civile dhe kulturore</li> <li>• Përfundimi i konfliktit të armatosur: përfundimi i thjeshtë i luftimeve; nënshtrimi; armëpushimi; kapitullimi; traktati i paqes (Oxford University Press, Oxford, 2008)</li> </ul> <p style="text-align: right;">Literature: Zejnullah Gruda, <i>E Drejta Ndërkombëtare Publike</i> (Prishtinë: 2013) Enver Hasani, <i>Tema të Zgjedhura nga e Drejta dhe Marrëdhëniet Ndërkombëtare</i> (Prishtinë: Jalifat Publishing &amp; Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina, 2016)</p>
<b>Java e pesëmbëdhjetë:</b>	<b>TESTI PËRFUNDIMTAR</b>

<b>Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:</b>	
<p><b>Cakto politikat e mirësjelljes konform statutit të UP-së.</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Studentët pritet që të vijojnë mësimin në mënyrë të rregullt.</li> <li>• Prezenca e studentit do të evidentohet përmes listave të pjesëmarrjes ku studentët prezent do të bëjnë nënshkrimin e tyre në fillim të orës.</li> <li>• Pjesëmarrja aktive e studentëve do të llogaritet në bazë të pjesëmarrjes aktive në ligjerata përmes interaktivitetit me mësimdhënësit dhe studentët tjerë; prezentimi i temave të ndryshme dhe puna individuale dhe në grupe varësisht nga detyrat e caktuara.</li> <li>• Studentëve do t’u jepet me kohë planprogrami dhe pritet që të paraprkishtë të lexojnë literaturën e rekomanduar për ligjeratën përkatëse dhe gjatë orës të involvohen në dialog interaktiv me lidhje me atë temë.</li> <li>• Studentët inkurajohen që të ngritin çështje të ndryshme për diskutim gjatë mbajtjes së ligjeratës.</li> <li>• Nuk mund të ngriten çështje për diskutim tema të cilat nuk lidhen me planprogramin e lëndës.</li> <li>• Caktimi i pushimit gjatë ligjeratave do të bëhet në bashkëpunim me studentët.</li> </ul>	